



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**  
**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË "PARTISË SHKODRA 2015" SI SUBJEKT**  
**ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS**  
**21.06.2015**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.04.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	LUZI-	Kryetare
Denar	BIBA-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Gëzim	VELESHNJA	Anëtar
Hysen	OSMANAJ-	Anëtar
Klement	ZGURI-	Anëtar
Vera	SHTJEFNI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" për regjistrimin si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 64, i ligjit nr 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.8844, datë 15.12.2014 ka caktuar datën 21.06.2015, për zhvillimin e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore.



**Nr. 158 i Vendimit**

**Data 16.04.2015**

**Ora .00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015

“Partia Shkodra 2015”, me shkronja nistore “SH 2015”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Vullnet Elbasani, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen më datë 21 Qershor 2015, administruar me nr. 2776 prot., datë 10.04.2015.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Shkodra 2015”, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Nga analiza e dokumentacionit paraqitur bashkëlidhur kërkesës, evidentohet respektimi, i kërkesave të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Konkretisht është paraqitur:

- emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- specimeni i vulës së partisë;
- emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z.Rezart Kastrati);
- emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KOZ-në (z. Rezart Kastrati);

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse konstatoi se, në dokumentacionin e paraqitur është pasqyruar vërtetim që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. datë 08.04.2015, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë. Sipas pikës 1 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, Partitë Politike të cilat janë të tilla pas regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mund të regjistrohen si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 jo me vonë se data 14 prill 2015 Vendimi i sipërcituar merr formë të prerë jashtë afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor për regjistrimin e partive politike.

Për sa më sipër, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga “Partia Shkodra 2015”, nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, germa a, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 64 pika 2, germa a, e Kodit Zgjedhor parashikon vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Tiranë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 21, pika 6, neni 23, pika 1, germa a, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



**Nr. 158 i Vendimit**

**Data 16.04.2015**

**Ora .00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Shkodra 2015” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015

## V E N D O S I :

1. Të mos regjistrojë Partinë Shkodra 2015", me kryetar z. Vullnet Elbasani, dhe shkronja nistore "SH 2015", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Lefterije</b>	<b>LUZI-</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA-</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Gëzim</b>	<b>VELESHNJA-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Hysen</b>	<b>OSMANAJ-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Klement</b>	<b>ZGURI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Vera</b>	<b>SHTJEFNI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 158 i Vendimit**

**Data 16.04.2015**

**Ora .00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21.06.2015